



**Raporti i Vlerësimit Paraprak të Ndikimit në Mjedis. Aktiviteti: “Prodhime infrastrukturore. b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat” të subjektit Varaku - E Sh.p.k**



**Me vendndodhje ne, Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private, Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30.**

**Pergatitur nga A Consultant Sh.p.k  
Shtator 2018**



Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
aconsultant.com.al  
Cel: 0696032083



## Permbajtja

<b>1. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.....</b>	<b>4</b>
1.1 Hyrje.....	4
1.2 Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese. ....	5
1.3 Flora & Fauna.....	5
1.4 Tokat, kategoria e tokes, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.....	8
<b>2. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ; .....</b>	<b>9</b>
2.1 Uji, akuiferet.....	9
2.2 Relievi dhe klima .....	10
<b>3. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR; .....</b>	<b>11</b>
3.1 Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne toke.....	11
3.2 Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.....	12
3.4 Shkarkimet ne ajer.....	12
3.5 Fenomene te tjera.....	13
3.6 Gjenerimi i mbetjeve .....	13
3.7 Ndikime ne biodiversitet.....	16
<b>4. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE; .....</b>	<b>16</b>
4.1 Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne toke.....	16
4.2 Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.....	17
4.3 Shkarkimet ne ajer.....	17
4.4 Zhurmat.....	18

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
[aconsultant.com.al](http://aconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



4.5	Fenomene te tjera.....	19
4.6	Gjenerim i mbetjeve.....	19
5.	INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA;.....	20
6.	TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS QE NENKUPTON DISTANCEN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QE PERFSHIHEN NE TE.....	22
7.	MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHI EDHE KTHIMIN E TOKËS BUJQËSORE (NË RAST SE PËRDORIMI EKZISTUES ËSHTË I TILLË) DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN; .....	22
8.	MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS.....	24
8.1	Identifikimi I masave zbutese.....	24
8.2	Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese.....	25
9.	SIGURIA DHE SHENDETI NE PUNE DHE PERGJEGJSHMERIA SOCIALE E KOMPANISE .....	27
10.	KONKLUZIONE .....	28
11.	Licenca e QKL-se, te A Consultant shpk dhe eksperteve per hartimin e raportit te VNM-se paraprake.....	30

#### Permbajtja e tabelave

Table 1.	Evidentimi i ujerave te ndotura .....	12
Table 2.	Mbetjet – Rikuperimi/asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme. ....	14
Table 3.	Te dhenat e monitorimit te ajrit ne Durres .....	18
Table 4.	Ndikimet e zhurmave gjate funksionimit te aktivitetit.....	19
Table 5.	Pamje e fikeseve te zjarrit .....	28

#### Permbajtja e Figurave

Figure 1.	Pamje e larget nga google earth per vendndodhjen e aktivitetit.....	4
Figure 2.	Pamje ne pjesen perpara subjektit Varaku- E shpk .....	8
Figure 3.	Pamje anash subjektit.....	9
Figure 4.	Te dhenat e klimes ne Durres. ....	11

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



# 1. PËRSHKRIM I MBULESËS BIMORE TË SIPËRFAQES KU PROPOZOHET TË ZBATOHET PROJEKTI.

## 1.1 Hyrje

Subjekti Varaku –E shpk eshte pajisur me nr Nipt. J61902509S dhe eshte rregjistruar ne QKB ne 23/08/1994 me aktivitet kryesor ne fushen e ndertimit dhe prodhimeve infrastrukturore te tilla si Rikonstruksion i Rrugeve (riparim, rindertim, vijezim, ndertim te urave etj) ndertim te ujesjellesit, ndertim te shkollave.

Subjekti Varaku E kerkon te pajiset me Akt Miratimin per VNM Paraprake per aktivitetin “Prodhime infrastrukturore. b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat”, me vendndodhje ne Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private, Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30.



Figure 1. Pamje e larget nga google earth per vendndodhjen e aktivitetit.

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
[aconsultant.com.al](http://aconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



## **1.2 Ekosistemet, habitatet dhe peisazhet ekzistuese.**

Zona ku ushtron aktivitetin kompania, eshte toke e zhveshur nga bimesia dhe kryesisht e mbuluar me barishte, me nje peisazh te zakonshem dhe nuk gezon ndonje status te vecante mbrojtje persa i perket flores, faunes dhe habitateve te ndryshme. Territori i kompanise eshte ne afersi te rruges kombetare Tirane-Durres. Bimet e zones, pervecse atyre bujqesore si hardhia, fiku, kumbulla, pjeshka, kajsia, qershia etj qe kultivohen ne zone, perfaqesohen dhe nga bime autoktone si ferra, plepa, akacie, etj, qe nuk preken nga zona, ku ushtrohet aktiviteti.

## **1.3 Flora & Fauna**

Pozita gjeografik, ndërtimi gjeologjik, kushtet klimatike, pasuria ujore dhe lloji i tokave të territoreve të Durrësit dhe të Shijakut kanë krijuar habitate të përshtatshme për botën e gjallë bimore e shtazore. Tërësia e llojeve të qënieve të gjalla që jetojnë në këto territore përbën biodiversitetin e Durrësit dhe të Shijakut. Në biodiversitetin e kësaj hapësire territoriale përfshihen të gjitha kafshët dhe bimët që zoologët dhe botanistët kanë zbuluar dhe përshkruar nga ana shkencore. Në këto territore gjenden bimë e kafshë endemike dhe relikte të evolucionit, por edhe bimë e kafshë të reja, që kërkojnë nevojën e studimeve të mëtejshme. Flora dhe fauna janë shoqërime të njëra-tjetrës, megjithëse të veçanta. Pozicioni gjeografik dhe veçoritë e kushteve natyrore i pozicionojnë territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut në biorajonin e tipit Mesdhetar. Ky pozicionim është përcaktuar sipas klasifikimit paleartik të habitateve. Më poshtë janë evidentuar të gjitha bimët dhe kafshët e njohura të sipërfaqeve tokësore dhe hapësirave ujore, të territorit bashkiak të Durrësit dhe të Shijakut.

Nga pikëpamja floristike, rrethi i Durrësit bën pjesë në zonën e shkurreve mesdhetare, te përfaqësuar nga dafina, shqopa dhe nga shkurret te tjera në formën e kacubeve te veçanta. Pranë bregut te detit shtrihet një brez gjelbërimi me pisha te zhvilluara mire.

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



Zona karakterizohet nga prania e një bimësie natyrore me moshe 80 vjeçare që dominohet kryesisht nga pisha e bute dhe e egër me moshe 19-24 vjeçare.

Gjate bregdetit gjendet një baze pyjore natyre prej dushku dhe shelgu me moshe 60-80 vjeçare, i alternuar me pyll artificial prej pishash e plepash me moshe 20 vjeçare.

Konditat klimatike te zonës lejojnë te zhvillohet një bimësi e shumëllojshme që nga pishat, plepi, frasheri i zi, morina, palma dhe dafina, deri në bimët e tjera dekorative si: frasheri gjethengushtë, vërrria, eukalipti, shelgu lotues, etj.

Kur temperatura mesatar është mbi 10 C periudha e vegjetacionit fillon në ditët e para te marsit dhe përfundon në ditët e para te dhjetorit. Në zonat me te larta te rrethit (p. sh. zona e Ishmit) rriten shkurre që i rrezojnë gjethet e tyre gjate atines se dimrit si: shkuza, murrizi, driza, etj. Në Xhafzotaj, Sukth, Gjipale, Spitall etj, rriten edhe bime te ulëta si: mullaga, hithra, lulekuqa, tatulla, kopra e egër, ndërsa gjethe delli, lulebasami, hithra, grami, rrodhja, netulla, bar pate rriten kryesisht në zonën e Shijakut, Maminasit, Katundi te Ri dhe Ishmit.

Përveç bimësisë pyjore që zë vend te rëndësishëm në bimësinë e rrethit, po kaq rendësi kane edhe kulturat bujqesore te përfaqësuar nga: gruri, misri, fasulja, ulliri, lule dielli, te cilat përhapjen me te madhe e kane në zonën e Shijakut, Maminasit, Spitalles, Sukthit. Pothuajse në te gjithë rrethin kultivohen perime si: speci, domatja, kastravec, bizelja, etj., dhe agrumet (portokalli, limoni) te cilat prodhohen me shume pergjate bregdetit.

Bota shtazore e Durrësit dhe Shijakut është e shumëllojshme, në varësi edhe të tërësisë së habitateve tokësore e ujore që gjenden në këto territore. Në grupin e faunës tokësore bëjnë pjesë gjitarët e tokës (mishngrënës dhe barngrënës), shpezët, zvarranikët, amfibët, insektet etj. Të gjitha kafshët tokësore të hapësirës territoriale të bashkive Durrës dhe Shijak, janë pothuajse të ngjashëm me ato të të gjithë Shqipërisë

Adresa: Dures Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj, Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com); web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



dhe mbarë Mesdheut. Bashkia e Durrësit dhe e Shijakut janë të pasura me lloje të shumta shpezësh të tokës dhe ujit, sedentarë dhe shtegtarë. Një pjesë e madhe e shpezëve banojnë në këto territore në mënyrë të përhershme e si të tillë, ata janë sedentarë. Por ka edhe një numër të madh shpendësh, të quajtur shtegtarë, që vijnë nga viset e Europës Veriore për të kaluar dimrin në këto territore. Disa të tjerë e kalojnë tek ne muajin e verës, ndërsa në dimër zbresin në viset më të ngrohta. Kemi dy grupe shpendësh, ato që shtegëtojnë në distanca të vogla dhe në distanca të mëdha (shtegëtime ndërkontinentale). Shpendët që vijnë për të dimëruar në territoret e këtyre bashkive janë tushat, laureshat etj; nga rendi i harabelave (Passeriformes); rosat e patat nga rendi i patorëve Anseriformes); disa shpendë nga rendi i pëllumbave të egër (Colmbiformes); nga rendi shapkave dhe i gjelzave të ujit (Charadruiformes) etj. Nga shpezët e grupit të dytë mund të përmendim disa lloje nga rendi i harabelorve, sic janë bilbilat (*Lucinia megarhyncha*), bilbilthat (gjinia *Sylvia*), bishtatundësit (gjinia *Motacilla*), dallëndyshet, bengat etj., ndërsa nga rendet e tjera shkurtat, turtujt etj. Pjesa më e madhe e shpezëve sedentarë i ndërtojnë foletë e tyre atje ku dimërojnë, por ka edhe shumë prej tyre që bëjnë migracione sezonale, kryesisht vertikale brenda vendit. Interesantë janë edhe migracionet ditore të shumë shpendëve, të cilët lidhen kryesisht me sigurimin e ushqimit. Krahas shpezëve të tokës, kemi edhe shpezët e ujit, që gjenden në ujërat bregdetare. Ato janë të familjes së rosave, patave (Anatidae), të shapkave (Scrolopacidae) etj. Në grupin e shpezëve të ujit bëjnë pjesë: Thëllëza e fushës (*Perdix perdix*, L), Shkurta (*Coturnix coturnix* L) etj. Bota e zvarranikëve është mjaft e pasur me lloje dhe ekzemplarë. Midis zvarranikëve të tokës përhapje më të madhe kanë breshkat, gjarpërinjtë dhe hardhucat. Breshkat e tokës përfaqësohen nga breshkat e zakonshme (*Testudo hermanni* Gmel.). Gjarpërinjtë janë më të shumtë e më të shumëllojtë. Përhapje të gjërë kanë ata jo helmues si: Shigjetat (*Coluber gemonensis*, *C. Najadum* e *C. Jugularis*) dhe disa bolla, si bolla e shtëpisë (*Elaphe longissima*) dhe bolla me katër vija (*Elaphe quatuorlineata*). Nga gjarpërinjtë helmues

Adresa: Dures Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



më i rrezikshmi është nepërka e zakonshme (Vipera ammodytes). Hardhucat- më e përhapur është hardhuca e mureve (Lacesta muralis) dhe zhapiku i gjelbër (Lacesta viridis, L), që banon në vende të mbuluara me shkurre e ferra.

#### **1.4 Tokat, kategoria e tokes, gjeologjia dhe gjeomorfologjia.**

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut përfshihen në Përkuljen Pranadriatike. Karakteristike janë depozitimet terrigjene, të periudhës neogjenike dhe depozitimet aluvionale, detare dhe lagunore-kënetore të periudhës kuaternare. Shkëmbinj të terrigjenë përfaqësohen nga molasat neogjenike, të moshës tortoniane, mesiniane dhe suitës Helmesi të pliocenit. I rëndësishëm është trajtimi i tyre sipas periudhave gjeologjike.

Ne fotot e mëposhtme jepen disa pamje të cilat ndodhen në afërsi të subjektit:



Figure 2. Pamje në pjesën përpara subjektit Varaku- E shpk

Adresa: Durrës Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj, Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083





Figure 3. Pamje anash subjektit

## 2. INFORMACIONI PËR PRANINË E BURIMEVE UJORE NË SIPËRFAQEN E KËRKUAR NGA PROJEKTI DHE NË AFËRSI TË SAJ;

### 2.1 Uji, akuiferet

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut bëjnë pjesë në pellgun ujëmbledhës të lumenjve Erzen, Ishëm dhe në pellgun ujëmbledhës të detit Adriatik. Kurrizi kodrinor Rodon-Erzen shërben si kufi ndarës i pellgjeve ujëmbledhëse të lumenjve të mësipërm. Pjesë të caktuara të fushës së Durrësit, të cilat kanë pjerrësi të vogël nga niveli i detit, i derdhin ujërat direkt në detin Adriatik. Rrjeti hidrografik sipërfaqësor përfaqësohet nga deti Adriatik, lumenjtë (Erzen dhe Ishëm), përrenjtë, prroskat, liqenet bregdetare dhe objektet ujore artificiale si: ujëmbledhësit dhe kanalet kullues të ndërtuar mbas vitit 1950. Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut kanë shtrirje të konsiderueshme të ujërave nëntokësore. Ujërat nëntokësore gjenden shumë pranë sipërfaqes së tokës.



Cilësia e ujërave nëntokësore nuk është e mirë për të furnizuar banorët me ujë të pijshëm. Ujërat nëntokësore kanë përmbajtje të lartë të kriprave dhe kjo lidhet edhe me përzierjen e ujërave nëntokësore me ujërat detare, si rezultat i afërsisë së tyre. Ushtrimi i aktivitetit nuk ndikon në ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore të zonës.

## 2.2 Relievi dhe klima

Territoret e bashkisë së Durrësit dhe të Shijakut, si pjesë territoriale e Shqipërisë, bëjnë pjesë në gjerësitë gjeografike mesatare. Dalja e gjerë në detin Adriatik, si pjesa më veriore e detit Mesdhe, i jep klimës tipare mesdhetare. Tipari dallues i klimës mesdhetare është ekzistenca e katër stinëve (pranvera, vera, vjeshta dhe dimri). Temperatura mesatare vjetore është 16°C. Muaji më i ngrohtë është Korriku me temperaturë mesatare 23.8°C. Dimri është i butë me ndikim të fortë detar. Temperatura mesatare e janarit lëkundet nga 7,5-8.2°C. Minimumet absolute zbresin deri në -6°C dhe -7°C. Karakteristikë e përgjithshme është përputhja e relievit me strukturën, ku përgjatë boshteve të strukturave sinklinale janë formuar fushat (e Durrësit dhe e Ishmit) dhe përgjatë boshteve të strukturave antiklinale janë formuar kodrat dhe vargje kodrinore (Durrës-Bishti i Pallës dhe Kepi i Rodonit-Prezë).

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
[aconsultant.com.al](http://aconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor
Temperatura mesatare(°C)	8.1	9	10.9	14	18.1	21.8	23.8	23.9	21.2	17.2	13	9.9
Temperatura minimale (°C)	4.8	5.6	6.9	9.7	13.6	17.2	19	19	16.5	13	9.5	6.5
Temperatur maksimale (°C)	11.4	12.5	14.9	18.3	22.6	26.5	28.7	28.8	26	21.4	16.6	13.3
Temperatura mesatare(°F)	46.6	48.2	51.6	57.2	64.6	71.2	74.8	75.0	70.2	63.0	55.4	49.8
Temperatura minimale (°F)	40.6	42.1	44.4	49.5	56.5	63.0	66.2	66.2	61.7	55.4	49.1	43.7
Temperatura maksimale (°F)	52.5	54.5	58.8	64.9	72.7	79.7	83.7	83.8	78.8	70.5	61.9	55.9
Rreshje / Shi (mm)	132	107	99	81	68	41	26	36	71	112	160	131

Figure 4. Te dhenat e klimes ne Durres.

### 3. NJË IDENTIFIKIM I NDIKIMEVE TË MUNDSHME NEGATIVE NË MJEDIS TË PROJEKTIT, PËRFSHIRË NDIKIMET NË BIODIVERSITET, UJË, TOKË DHE AJËR;

#### 3.1 Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne toke.

Nuk aplikohet.

Gjate aktivitetit te kompanise nuk ka shkarkime ne toke. Te gjitha mjediset ku subjekti kryhen aktivitetin ekonomik jane te shtruara me beton.

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
[aconsultant.com.al](http://aconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



### 3.2 Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.

Nuk aplikohet.

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk ka shkarkime ne ujerat siperfaqesore. Subjekti ka ndertuar nje sistem te mbledhjes se ujrave (te shirave, dhe nga pastrimi i siperfaqeseve te shtruara) siperfaqesore, me pas keto ujera shkarkohen ne rrjetin e kanalizimeve te komunes Xhafzotaj. Ne rrjetin e kanalizimeve te komunes Xhafzotaj shkarkohen ujera te cilat perdoren per qellime higjieno-sanitare. Kompania nga zhvillimi i aktivitetit nuk gjeneron ujera te ndotura/komtaminuara, etj.

Table 1. Evidentimi i ujrave te ndotura

Pyetje	PO	JO	Nqs PO shkruaj (Tipin, sasine & burimin)
A ka shkarkime te ujrave te ndotura?		X	
A ka ujera te ndotura me natyre toksike?		X	
A behen shkarkime ne rrjetin e kanalizimeve?		X	Uji i perdorur per larjen e mjediseve te jashtme te fabrikes si dhe ujerat e perdorura per qellime higjiene ne mjediset e fabrikes.
A behen shkarkime ne siperfaqet ujore?		X	

### 3.4 Shkarkimet ne ajer.

Burimet kryesore te identifikuara gjate procesit te prodhimit te asfaltit, te cilat mund te ndikojne ne mjedisin perreth nga shkarkimet ne ajer jane furra dhe kaldaja.

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
[aconsultant.com.al](http://aconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



- 1- Furra sherben per largimin e avujve te ujit qe dalin nga ngrohja e materialeve inerte. Keto avuj kalojne ne nje kolektor te vecante dhe filtrohen nerpermjet filtrit te madh i perbere nga 40 filtra mence.
- 2- Kaldaja qe punon me gaz dhe solar, sherben per ngrohjen e bitumit. Gazet e djegies nga kaldaja shkarkohen ne atmosfere me ane te oxhakut.

### 3.5 Fenomene te tjera.

Nuk aplikohet.

### 3.6 Gjenerimi i mbetjeve

a- Mbetjet e gjysme prodhimit krijohen ne momentin qe shkarkohet produkti asfalt nga sillosi i asfaltit per ne makinerine, qe me pas kryen transportin e produktit, keto mbetje gjenerohen ne sasi shume te vogla dhe rifuten serisht ne proces.

b- Mbetje te metaleve, gjenerohen ne momentin qe makinerite e linjes se asfaltit dhe te betonit mund te demtohen. Keto mbetje nuk kane nje kohe te percaktuar te gjenerimit, por ne momentin e difekteve nderpriten punimet.

c- Mbetje te filtrave, vijne si rezultat i nderrimit te tyre. Filtrat jane te instaluar ne oxhakun e linjes se impiantit per prodhimin e asfaltit. Eshte nje person pergjegjes per vendosjen dhe nderrimin e filtrave. Filtrat nderrohen nje here ne tre vjet. Perkohesishte filtrat ruhen ne kazane, ne nje vend specifik ne subjektin Varaku-E, sepse ne Shqiperi akoma nuk ka kompani te cilat mund te kryejne procesin e perpunimit te metejshem te filtrave te perdorur.

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
[aconsultant.com.al](http://aconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



Table 2. Mbetjet – Rikuperimi/asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme.

Te dhenat e mbetjeve per te cilat subjekti aktualisht raporton.

Tipi i mbetjes	Numri nga Rregullorja për Kategoritë e Mbetjeve, duke përfshirë listat	Vendi kryesor i gjenerimit	Sasia		Trajtimi ose asgjësimi në instalim/impianit (Metoda dhe vendndodhja)	Trajtimi, rikuperimi ose riciklimi jashtë instalimit/impianit (Metoda, vendi, kontraktori)	Asgjësimitrajtimiti jashtë instalimit/impianit (Metoda, vendi, kontraktori)
			Ton/muaj	m3 /muaj			
Mbetje zhavorri dhe mbetje guresh te tjera nga ato te permendura ne 01 03 07	01 04 08 (VKM 99)	Depozita e lendes se pare	0.5 ton/vit		Keto mbetje riperdoren ne proces si lende e pare.	-	-

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
aconconsultant.com.al  
Cel: 0696032083



Metale ferore	16 01 17 (VKM 99)	Nga linja e impiantit te asfaltit dhe betonit	0.5 ton/vit		Nuk aplikohet. Mbetjet ruhen perkohesishte ne magazine, deri sa te largohen nga subjekte te licensuara.	-	Merren nga kompani te licensuara per trajtim te metejshem.
Mbetje urbane	20 03 99 (VKM 99)	Nga konsumi i drekes se punonjeseve	7kg/dite		Ruhen perkohesisht ne koshat e vendosura nga subjekti, me pas dergohen ne kazanet e vendosura nga pushteti lokal.	Merren nga kompani te pastrimit te komunes Xhafzotaj	Merren nga kompani te licensuara per trajtim te metejshem.
Mbetje te filtrave	15 02 03 (VKM 99)	Nga linja e impiantit te asfaltit	-		Nuk aplikohet. Ruhen ne kazane te posacem ne vendin e percaktuar nga drejtuesi i subjektit.	Ruhen ne kazane te posacem ne vendin e percaktuar nga drejtuesit e subjektit.	-

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
aconsultant.com.al  
Cel: 0696032083



### 3.7 Ndikime ne biodiversitet.

Zona ku ushtron aktivitetin subjekti, eshte toke e zhveshur nga bimesia dhe kryesisht e mbuluar me barishte, me nje peisazh te zakonshem dhe nuk gezon ndonje status te vecante mbrojtje persa i perket flores, faunes dhe habitateve te ndryshme. Territori i kompanise eshte ne afersi te rruges kombetare Tirane-Durres. Bimet e zones, pervecse atyre bujqesore si hardhia, fiku, kumbulla, pjeshka, kajsia, qershia etj qe kultivohen ne zone , perfaqesohen dhe nga bime autoktone si ferra, plepa, akacie, etj, qe nuk preken nga zona, ku ushtrohet aktiviteti.

## 4. NJË PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET E MUNDSHME NË MJEDIS, TË TILLA SI: UJËRA TË NDOTURA, GAZE DHE PLUHUR, ZHURMË, VIBRIME, SI DHE PËR PRODHIMIN E MBETJEVE;

### 4.1 Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne toke.

Aktiviteti i Impiantit per prodhimin e asfaltit kalon neper disa procese, te cilat jane te mire llogaritura, sasite e materialeve te para per te prodhuar nje sasi te caktuar asfalti (dhe ne rast mbetjesh te gjysme prodhimit asfalti keto jane ne sasi te vogla dhe hyjne perseri ne proces).

Subjekti Varaku-E sh.p.k ka përvetësuar planet më të mira të menaxhimit të mbetjeve, qe gjenerohen gjate funksionit te aktivitetit, sic mund te permendim:

- reduktimin e mbetjeve;
- Largimi i mbetjeve qe nuk mund te trajtohen ne impiant, nga subjekte te licensuara;

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083





- Mbetjet urbane të krijuara nga aktiviteti jetësor i punonjësve si dhe ambalazhet e materialeve të ndërtimitne menyre periodike dergohen nga subjekti ne vend-grumbullimin e tyre, te percaktuar nga pushteti lokal;
- Kontrolli periodik i mjeteve kryhet ne nje vend te specializuar;
- Mbetje te filtrave ruhen ne vende te specifikuar (ne kazane), deri sa te largohen nga subjekte te licensuara.

Asnjë nga këto materiale nuk paraqet një rrezik mjedisor te rendesishem dhe te menjëhershëm nëse do te menaxhohet siç duhet.

#### **4.2 Shkarkimet dhe ndikimi i tyre ne uje.**

Nga zhvillimi i aktivitetit te linjes se prodhimit te asfaltit dhe betonit nuk kemi ndotje te ujrave siperfaqesore. Per lagjen e siperfaqeve te kompanise perdoret uje i rrjedhshem per te ulur nivelin e pluhurave gjate diteve me kohe te thate. Subjekti ka krijuar puseta ku mblidhen ujrat siperfaqesore (ujra te shirave dhe te pastrimit te ambienteve te jashtme). Ujrat siperfaqesore nuk jane te ndotura.

Nga procesi i zhvillimit te aktivitetit nuk ka ndikime negative te shkarkimeve nga perdorimi i tualeteve.

Ne subjektin Varaku – E nuk kemi shkarkime te ndotjeve ne ujrat nentoksore. Aktiviteti zhvillohet ne nje hapësire e cila eshte e shtruar me beton.

#### **4.3 Shkarkimet ne ajer.**

Nga te dhenat e monitorimit te cilesise se stacionit te monitorimit te ajrit ne Durres (vendosur prane Poliklinikes) rezultojne te dhena si me poshte:

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
aconconsultant.com.al  
Cel: 0696032083

Table 3. Te dhenat e monitorimit te ajrit ne Durres

Viti	SPM $\mu\text{g}/\text{m}^3$	PM <sub>10</sub> $\mu\text{g}/\text{m}^3$	SO <sub>2</sub> $\mu\text{g}/\text{m}^3$	NO <sub>2</sub> $\mu\text{g}/\text{m}^3$	O <sub>2</sub> $\mu\text{g}/\text{m}^3$	Pb $\mu\text{g}/\text{m}^3$
2005	201	91	16	22	98	0.29
2006	201	93	19	24	106	0.28
2007	211	100	15	23	99	0.26
Kufijte Shqiptare	140	60	35	60	65	140
Kufijte KE	-	40	20	40	-	0.5

Sikurse vihet re Durresi ka nje tejkalim te normave shqiptare per pluhurin total dhe ozonin. Zona ku eshte vendosur aktiviteti ndodhet ne afersi te rruges kryesore dhe jane nen ndikimin e ndotjes se shkaktuar nga levizja e automjeteve ne keto rruge.

#### 4.4 Zhurmat.

Gjate zhvillimit te aktivitetit ne subjekt gjenerohen zhurma, si shkak i proceseve teknologjike qe realizohen per te perftuar produktin final.

Ndikimet negative nga krijimi i zhurmave ne raste avarish mund te jene:

- Shurdhimin e perkohshem apo te perhershem;
- Rritja e presionit te gjakut etj;
- Mekaniket, shoferet, manovraret, punonjesis qe jane pranë ambienteve të zhurmave, të gjithë mund te kenë dëmtime në sistemin e dëgjimit;
- Reduktimii efiçencës në punë dhe lodhja. Duke qenë se zhurma shkakton mungesën e përqendrimit njerëzit duhet të harxhojnë më shume kohë në



përqendrimin e tyre për të realizuar detyrat e tyre duke sjellë kështu mbilodhje.

Table 4. Ndikimet e zhurmave gjate funksionimit te aktivitetit

Pyetje	Po	JO	Nqs Po shkruaj (tipin, sasine & burimin)
A gjenerohen zhurma	Po		Zhurma gjenerohen gjate kohes se funksionimit te linjes se prodhimit te asfaltit si dhe gjate procesit te ngarkimit te mjeteve me produktet e asfaltit.
A gjenerohen vibracione?		JO	

#### 4.5 Fenomene te tjera.

Nuk aplikohet.

#### 4.6 Gjenerim i mbetjeve

Subjekti Varaku-E sh.p.k ka përvetësuar planet më të mira të menaxhimit të mbetjeve, qe gjenerohen gjate funksionit te aktivitetit, sic mund te permendim:

- Reduktimin e mbetjeve;
- Largimi i mbetjeve qe nuk mund te trajtohen ne impiant, nga subjekte te licensuara;
- Mbetjet urbane të krijuara nga aktiviteti jetësor i punonjësve si dhe ambalazhet e materialeve të ndërtimitne menyre periodike dergohen nga subjekti ne vend-grumbullimin e tyre, te percaktuar nga pushteti lokal;

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
aconsultant.com.al  
Cel: 0696032083



- Kontrolli periodik i mjeteve kryhet ne nje vend te specializuar;
- Mbetje te filtrave ruhen ne vende te specifikuar (ne kazane), deri sa te largohen nga subjekte te licensuara.

Asnjë nga këto materiale nuk paraqet një rrezik mjedisor te rendesishem dhe te menjëhershëm nëse do te menaxhohet siç duhet.

## **5. INFORMACIONI PËR KOHËZGJATJEN E MUNDSHME TË NDIKIMEVE NEGATIVE TË IDENTIFIKUARA;**

Subjekti Varaku- E sh.p.k ka perdorur praktikat dhe teknologjitë më të mira për të kontrolluar dhe për të zvogëluar shkarkimet nga zhvillimi i aktivitetit te tij.

Subjekti zbaton sistem te menaxhimit mjedisor, shendetit dhe sigurise ne pune, sistem te punimeve ne rruge gjate periudhes se rikonstruksionit, sistem te menaxhimit te cilesise per zhvillimin e aktivitetit. Per te siguruar nje performace mjedisore te qendrueshme ka marre nje sere masash ku nder to mund te permendim:

- Subjekti ka punesuar staf te specializuar per mbajtjen e sistemeve ISO.
- Furnizimi i automjeteve te transportit behet me karburant sipas cilesise se percaktuar ne VKM nr.147,date 21.03.2011, sherbimi i automjeteve kryhet nga subjekte te licensuara;
- Pajisjet qe perdoren per zhvillimin e aktivitetit “Impiant per prodhimin e asfaltit dhe betonit” gjenerojne zhurma brenda normave te lejuara ne fuqi.
- Subjekti ka instaluar filtra ne oxhak, te cilet kryejne pastrimin e avujve (kapjen e pluhurave) qe dalin;
- Subjekti ka shtruar siperfaqet perreth impiantit, per te evituar ngritjen e pluhurave gjate punimeve;

Adresa: Dures Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



- Jane marre masa te forta organizative dhe teknike parandaluese, qe te mos kete derdhje lendesh dhe ndotje ne mjedis duke ruajtur keshtu nje mjedis te paster. Subjekti ka procedura te evidentit te ndikimeve te mundeshme dhe ka hartuar plane veprimit per zbutjen e tyre.

Masat qe merren per te minimizuar ndikimin ne mjedis jane:

- Parandalimi i shkarkimeve te lendes pare ne mjedis.
- Lidhur me mbetjet e grumbulluara te menaxhohen ne bashkepunim me subjekte te licensuara ose me subjektin e grumbullimit te mbetjeve urbane.
- Sasia depozituese te mos i kaloje volumet e parashikuara ne menyre qe situata te jete e kontrollueshme dhe te demtoje instalimin.
- Te zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri ne menyre qe te perballoje siperfaqen ne rastet e avarive te ndryshme.
- Punonjesit te jene te trajnuar paraprakisht dhe te jene vazhdimisht ne mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjate proceseve te punes. Punimet e mirembajtjes te kryhen ne perputhje me kushtet teknike te punes.
- Te mirembahet brezi i pemeve pergjate murit rrethues te prones, ne menyre qe te reduktoje impaktin ne peizazh.
- Te behet sperkatja e sheshit gjate muajve Prill - Tetor me qellim reduktimin e ngritjes se pluhurit ne ajer.

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



## **6. TE DHENA PER SHTRIRJEN E MUNDSHME HAPESINORE TE NDIKIMIT NEGATIV NE MJEDIS QE NENKUPTON DISTANCEN FIZIKE NGA VENDNDODHJA E PROJEKTIT DHE VLERAT E NDIKUARA QE PERFSHIHEN NE TE.**

Ndikimet e mundeshme qe mund te rezultojne nga ky aktivitet jane te karakterit lokal dhe nuk shtrihen ne zona te tjera perreth aktivitetit. Sikurse eshte shpjeguar ne paragrafin e ndikimeve dhe masava zbutese ndikimet jane minimale dhe jo te rendesishme ne kontekstin rajonal apo nderkufitar.

## **7. MUNDËSINË E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR DHE MUNDËSINË E KTHIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR TË SIPËRFAQES NË GJENDJEN E MËPARSHME, PËRFSHI EDHE KTHIMIN E TOKËS BUJQËSORE (NË RAST SE PËRDORIMI EKZISTUES ËSHTË I TILLË) DHE KOSTOT FINANCIARE TË PËRAFËRTA PËR REHABILITIMIN;**

### **Masa rehabilituese pas perfundimit te aktivitetit**

Subjekti Varaku-E sh.p.k ka ndermarre masa paraprake per reduktimin e ndikimit ne mjedis gjate fazes se funksionimit si edhe pas ndërprerjes së aktivitetit.

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
aconconsultant.com.al  
Cel: 0696032083



### **Gjate fazes se funksionimit te aktivitetit “Impiant per prodhimin e asfaltit”**

- Percaktimii diteve me te pershtatshme per prodhim, referuar edhe kerkesave te klienteve.
- Gjate diteve te punes, respektimi I orarit zyrtare 08<sup>00</sup>:16<sup>30</sup>
- Kufizimi i shpejtësise se lëvizjes së mjeteve të punës në rrugët pranë shtëpive të banimit dhe gjate zhvillimi te punës.
- Monitorimi i cilësisë së ajrit periodikisht sipas kushteve të vendosura në lejen e mjedisit.
- Kontrolli teknik i mjeteve të punës.
- Mirembajtja dhe remontet e rregullta te makinerive dhe paisjeve qe shkaktojne zhurma;

### **Masa rehabilituese pas perfundimit te aktivitetit**

- Largimin e makinerive dhe pajisjeve;
- Largimi i platformave prej betoni apo cdo materiali tjetër, mbetje ndertimi apo hekuri nga siperfaqja e perdorur;
- Sistemimi i tokes;
- Hartimi I nje plani duke patur parasysh territorin ne te cilin zhvillohet aktiviteti;
- Duke qene se siperfaqja ku zhvillohet aktiviteti eshte ne pronesi te vet pronarit te imipantit atehere, ai do te vendosi nese kete hapesire do ta zhvilloje per te ngritur nje aktivitet tjetër ekonomik ose nese do te kthehet ne gjendjen e ngjashme me te meparshmen;
- Nese mjedisi do te kthehet ne gjendjen e ngjashme me te meparshmen atehere do mendohet c'fare bimesie zhvillohet. Toka ka qene toke bujqesore dhe duhet patur parasysh llojin e kultivarit qe duhet mbjellur.

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconultantal@gmail.com](mailto:aconultantal@gmail.com) ; web:  
[aconultant.com.al](http://aconultant.com.al)  
Cel: 0696032083



## 8. MASAT E MUNDSHME PER SHMANGIEN DHE ZBUTJEN E NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

### 8.1 Identifikimi I masave zbutese

Aktiviteti i Impiantit per prodhimin e asfaltit kalon neper disa procese, te cilat jane te mire llogaritura, sasite e materialeve te para per te prodhuar nje sasi te caktuar asfalti (dhe ne rast mbetjesh te gjysme prodhimit asfalti keto jane ne sasi te vogla dhe hyjne perseri ne proces).

Subjekti Varaku-E sh.p.k ka përvetësuar planet më të mira të menaxhimit të mbetjeve, qe gjenerohen gjate funksionimit te aktivitetit, sic mund te permendim:

- Reduktimin e mbetjeve;
- Largimi i mbetjeve qe nuk mund te trajtohen ne impiant, nga subjekte te licensuara;
- Mbetjet urbane të krijuara nga aktiviteti jetësor i punonjësve si dhe ambalazhet e materialeve të ndërtimitne menyre periodike dergohen nga subjekti ne vend-grumbullimin e tyre, te percaktuar nga pushteti lokal;
- Kontrolli periodik i mjeteve kryhet ne nje vend te specializuar;
- Mbetje te filtrave ruhen ne vende te specifikuar (ne kazane), deri sa te largohen nga subjekte te licensuara.

Asnjë nga këto materiale nuk paraqet një rrezik mjedisor te rendesishem dhe te menjëhershëm nëse do te menaxhohet siç duhet.

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083





## **8.2 Vleresimi i efektivitetit te pritshem te masave zbutese.**

Subjekti Varaku-E sh.p.k ka hartuar nje list me ndikimet ne negative qe mund te sjelle ne mjedis moskoordinimi I disa faktoreve sic jane te pershkruara me poshte:

- 1-Derdhje e lendes se pare;
- 2-Defektet teknike te makinerive;
- 3-Aksidente ne pune;
- 4-Kalimi I afatit te perdorimi te filtrave.

### Masat ekzistuese ne fabrike gjate ushtrimit te aktivitetit.

Zhvillimi i aktivitetit, si cdo aktivitet tjeter ekonomik dhe industrial mbar riskun e ekspozimit te punonjesve ndaj makinerive dhe rreziqeve, qe lidhet me manovrimin dhe funksionimin e tyre. Kompania Varaku - E shpk ka marre masa per ndergjegjesimin dhe trajnimin, sigurimit te pajisjeve mbrojtese personale, si dhe ngritjes se strukturave dhe procedurave perkatese per te shmangur aksidentet dhe per te siguruar nje mjedis te sigurte dhe te shendetshem ne vendin e punes per stafin e saj.

### Mbrojtja nga zjarri:

Per te eliminuar cdo lloj mundesie te rrezikut nga zjarri, subjekti ka instaluar sisteme hidrant, depozita uji, si dhe do te pajiset me fikese zjarri me shkume ne cdo front pune, per te shuar zjarrin ose perhapjen e tij, ne cdo rast te ndodhjes se ndonje zjarri. Hidrantet furnizohen me uje nga tubacione celiku dhe mbulojne teresisht territorin e jashtem dhe te brendshem te nderteses. Uji eshte siguruar nga subjekti me investimet e veta. Punetoret dhe administrata do te trajnohen vazhdimisht per rrezikun e shperthimit te zjarrit dhe per shuarjen e tij ne cdo rast. Plani i emergjencave eshte nje ndër planet kryesore që duhet të ketë hartuar gjate zhvillimit te aktivitetit "Impiant per prodhimin e asfaltit". Plani i emergjencave ka për qëllim ruajtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit si dhe mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet njohjes dhe zbatimit të tij arrihet shmangia e aksidenteve në frontin e punës ose menaxhimi i shpejtë i aksidenteve.

Adresa: Dures Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



Personeli njih mirë të gjitha proceset që kryhen gjate zhvillimit te aktivitetit në mënyrë që te arrijë të kuptojë situatën, shkaqet dhe të jetë i përgatitur për menaxhimin e avarisë apo aksidentit.

Masat për parandalimin e avarive dhe aksidenteve në frontin e punës janë:

- Përdorimi i mjeteve dhe paisjeve të cilat janë në gjëndje të mirë teknike;
- Kryerja e serviseve periodike te mjeteve;
- Eshte ndertuar këndi i ndihmës së shpejtë dhe eshte i njohur nga i gjithë personeli.
- Janë vendosur tabela/njoftime ku tregohen pikat kyçe të rrezikut, jane publikuar numrat e kontaktit të supervizorit të emergjencave.

Mbrojtja e mjedisit:

Varaku E shpk ne vijimesi ka implementuar dhe ka mbajtur sistemet ISO te nevojshme per ushtrimin e aktivitetit ekonomik per te siguruar vazhdimesine e aktivitetit dhe ofrimin e produktit dhe sherbimit me te mire ne treg si dhe ne mbrojtjen e mjedisit. **NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR (NESE PROJEKTI KA NATYRE TE TILLE)**

Nuk aplikohet.

Subjekti Varaku – E shpk ndodhet ne xhafzotaj. Ne afersi te subjektit kalon autostrada Tirane - Durres. Pozicioni gjeografik I vendndodhjes se subjektit nuk ka shtrirje ne mjedisin nderkufitar.

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconconsultant@gmail.com](mailto:aconconsultant@gmail.com) ; web:  
[aconconsultant.com.al](http://aconconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



## 9. SIGURIA DHE SHENDETI NE PUNE DHE PERGJEGJSHMERIA SOCIALE E KOMPANISE

Subjekti Varaku E shpk ka rreth 24 vite qe ushtron aktivitetin e tij ekonomik dhe me kalimin e viteve ka krijuar emrin e tij ne tregun Shqiptar. Synimi kryesor I drejtuesve te subjektit ka qene dhe vazhdon te jete funksionimi I aktiivitetit duke I permbajtur te gjitha detyrimeve ligjore per ushtrimin e aktivitetit ekonomik si dhe duke mbrojtur shendetin e punonjesve. Subjekti nder vite ka perfaqafuar teknikat me te mira mjedisore per ushtrimin e aktivitetit. Subjekti ka marre konsulenca nga ekspert dhe organizma te akredituara per implementimin dhe mirembajtjen e sistemeve ISO nder vite;

Sistemet e ISO te impelmentuara jane:

- 1- ISO 9001:2005-Ndertim dhe rikonstrukcion te infrastruktures rrugore, ndertesave civile dhe industriale, ujesjellsave dhe kanalizimeve, prodhim dhe shitje te asfaltit dhe betonit.
- 2- ISO 14001:2015-Ndertim dhe rikonstrukcion te infrastruktures rrugore, ndertesave civile dhe industriale, ujesjellsave dhe kanalizimeve, prodhim dhe shitje te asfaltit dhe betonit.
- 3- ISO 18001:2007-Ndertim dhe rikonstrukcion te infrastruktures rrugore, ndertesave civile dhe industriale, ujesjellsave dhe kanalizimeve, prodhim dhe shitje te asfaltit dhe betonit.
- 4- ISO 50001:2011-Certifikimi i sistemit per menaxhimin e energjise.
- 5- ISO 39001:2012-Sistem i menaxhimit te sigurise se trafikut rrugor.
- 6- PAS 99:2012-Sistem i menaxhimit te integruar.
- 7- ISO/IEC 27001:2013-Certifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise se informacionit.

Per mirembajtjen e ketyre sistemeve eshte punesuar personel I kualifikuar I cil ndjek te gjitha hapat qe nga implementimi, trajnimi dhe updetimi I ketyre sistemeve kur eshte e nevojshme.

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
[aconsultant.com.al](http://aconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083

**Mbrojtja nga zjarri:** Masa kryesore qe subjekti eshte kujdesur gjithmone qe te jete ne qender te vemendjes eshte parandalimi dhe mbrojtja nga zjarri. Per kete arsye subjekti kryhen vazhdimesisht trajnime (ku jane percaktuar edhe planimetria e pergjithshme e aktivitetit per njohjen e zonave te mundshme te ndodhjes se zjarrit) se si te parandalojme dhe nese ndodh si mund te mbrohemi nga zjarri me disa hapa te thjesht:

- 1- Njofto ne rast zjarri.
- 2- Nese je I rrezikuar nga nje vater zjarri SHPETO VETEN
- 3- Mblidhu ne nje zone te sigurt (e percaktuar nga drejtuesi teknik I subjektit)
- 4- Perdor fikeset e zjarrit

Fikeset e zjarrit jane vendosur ne vende te dukshme.



Table 5. Pamje e fikeseve te zjarrit

## 10. KONKLUZIONE

Subjekti Varaku –E shpk eshte pajisur me nr Nipt. J61902509S dhe eshte rregjistruar ne QKB ne 23/08/1994 me aktivitet kryesor ne fushen e ndertimit dhe prodhimeve



infrastrukturore te tilla si Rikonstrukcion i Rrugeve (riparim, rindertim, vijezim, ndertim te urave etj) ndertim te ujesjellesit, ndertim te shkollave.

Subjekti Varaku E kerkon te pajiset me Akt Miratimin per VNM Paraprake per aktivitetin "Prodhime infrastrukturore. b) Projekte për zhvillime urbane, duke përfshirë dhe ndërtimin e qendrave tregtare dhe parkimet për makinat", me vendndodhje ne Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private, Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30.

Per mirefunksionimin e aktivitetit masat e ndermarra nga drejtuesit te subjektit jane:

- Parandalimi I ndikimeve te shkarkimeve ne mjedisin perreth;
- Marrja e pergjegjesive sociale dhe ligjore ne rast te ndodhjes se incidenteve/aksidenteve, njoftimi I organeve kompetente;
- Perfshirja e publikut ne vendimmarrje dhe informimi I tij mbi menyren e ushtrimit te aktivitetit;
- Implementimi gjithmone I teknologjive bashkekohore per ushtrimin e aktivitetit ekonomik;

Nga te gjitha masat e ndermarra nga subjekti nder vite theksojme me bindje qe permiresimi I proceseve te punes rrit ne te njejten kohe cilesine e sherbimit dhe te produktit si dhe identifikon aspiratat e mevonshme per mirefunksionimin e aktivitetit. Rritja e kapitalit te subjektit do te thote pagim I taksave dhe tarifave vendore si dhe permiresimin e infrastruktures se zones lokale.

Gavrosh Zela

**Ekspert mjedisi**

Flutura Nuredini

**Per: A Consultant sh.p.k**



Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
[aconsultant.com.al](http://aconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



## 11. Licenca e QKL-se, te A Consultant shpk dhe eksperteve per hartimin e raportit te VNM-se paraprake.

Certifikata e A Consultant shpk

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
Ministria e Ekonomisë,  
Tregtisë dhe Energjetikës

LICENCË

OKL

EN-3638-07-2011  
Kodi: 012.A(1+2)  
Data e lëshimit: 29/07/2011  
Adresa vlefshëmërisë: Pa afër

A CONSULTANT  
NUI(NPT): 102412001F  
Tirane, TIRANE, Tirane, TIRANE,  
Rruga Frosko Plaku, pallati 79.

Emërtimi përshirës i veprimtarisë  
Veprimtari e ekspertizës lidhur me ndëkëmbim në mjedis

Kodi i gjendjes:  
Kufizime specifike  
Licenca ardhmërisht sipas kufizimeve të licencimit në fjalë

Kategoria  
Shërbime ekspertizë dhe/ose profesionale lidhur me ndëkëmbim në mjedis

Nënkategoria  
Veprimtari e ekspertizës lidhur me ndëkëmbim në mjedis

Veprimtari specifike  
1. Ndëkëmbim në mjedis  
2. Auditim mjedisor

Specialiteti

Nënkëmbimi i agjencisë: *Antonia R. H.*

**Kjo Certifikate eshte e vlefshme per  
"Prodhime infrastrukturore. b) Projekte  
per zhvillime urbane, duke përfshirë dhe  
ndërtimin e qendrave tregtare dhe  
parkimet për makinat", Varaku E sh.pk**

Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
[aconsultant.com.al](http://aconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



Certifikata e eksperteve qe pergatiten dosjen:



Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
[aconsultant.com.al](http://aconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083



Adresa: Durres Xhafzotaj XHAFZOTAJ Godinë private,  
Zona Kadastrale 3852, Nr.Pasurie 19/30

Rr.Rustem Haklaj,Koder-Kamez, Tirana, Albania  
email: [aconsultantal@gmail.com](mailto:aconsultantal@gmail.com) ; web:  
[aconsultant.com.al](http://aconsultant.com.al)  
Cel: 0696032083